

## Programi i Investimit të Kapitalit Sipërmarrës III (VCIP III)

Vendndodhja:  
Rajonale

Numri i Projektit:  
53257

Sektori i biznesit:  
Telekomunikacion, media dhe teknologji

Lloji i njoftimit:  
Privat

Kategoria mjedisore:  
FW

Data e miratimit:  
23 shkurt 2022

Statusi:  
**Koncepti i rishikuar**

Data e bërjes publike të PSD-së në gjuhën angleze:  
14 janar 2022

## Përshkrimi i Projektit

BERZH-i, me anë të Programit të Investimit të Kapitalit Sipërmarrës III (VCIP III), që është një vijim i programit të investimit të kapitalit sipërmarrës të Bankës nëpërmjet dy kuadrove të mëparshëm, VICP I dhe VCIP II, do të synojë të investojë në fazat e para dhe ato të zhvillimit të shoqërive në fushën e teknologjisë, me kapital dhe me instrumente të lidhura me kapitalin (masa e investimit do të jetë deri në 25 milion euro), në vendet ku operon Banka, me përkrahjen e bashkinvestitorëve me përvojë në kapitalin sipërmarrës. Investimet do të kenë në shënjestër shoqëri të vogla dhe të mesme novatore dhe me rritje të madhe, që kryesisht nuk shërbejnë mjaftueshëm nga komuniteti i kufizuar i kapitalit sipërmarrës, për të ndihmuar në mbushjen e boshllëkut në lidhje me investimet të kapitalit sipërmarrës në treg.

## Objektivat e Projektit

Objektivi gjithëpërfshirës i VCIP III është zhvillimi dhe komercializimi i teknologjive novatore dhe tërheqja e fondeve kryesore të kapitalit sipërmarrës për vendet ku operon Banka, në të cilat disponueshmëria e kapitalit sipërmarrës është ende shumë e ulët dhe ekosistemet e kapitalit sipërmarrës janë ende në fillesat e veta.

Objektivat e tjerë kryesorë janë: (i) Kuadrot VCIP i mundësojnë Bankës t'iu japë shtysë ekonomike të njohurive në rajonin e BERZH-it, të zhvillojë ekosistemet e teknologjisë dhe të mbështesë novacionin; (ii) nëpërmjet Kuadrove VCIP, Banka luan

një rol të rëndësishëm në sheshimin e hendekut të financimit me kapital sipërmarrës që është i pranishëm në rajonin e BETZH-it; (iii) Kuadrot VCIP i mundësojnë Bankës të ndjekë një qasje me portofol të specializuar ndaj mundësive të investimit me risk të lartë dhe me kthim të lartë.

## Ndikimi i Tranzicionit

Pikët NPT (ndikimi i pritshëm i tranzicionit): 80

VCIP III pritet të kontribuojë në cilësitë konkurruese dhe ripërtëritëse të tranzicionit, pasi do të mbështesë zhvillimin e shoqërive të sapothemeluara shumë novatore të bazuara teknologji, si dhe do të promovojë qasje më të mirë në kapitalin sipërmarrës, që është ende në fillesat e veta në rajonin e BERZH-it.

Duke investuar në shoqëri me digjitalizimin në plan të parë, të cilat ofrojnë zgjidhje të bazuara në teknologji për tregun, VCIP III do të kontribuojë drejtpërdrejt në prioritetin e BERZH-it, konkretisht në Kuadrin Strategjik dhe të Kapitalit, për të përshpejtuar tranzicionin digjital. Zgjerimi i mëtejshëm i aktivitetit VCIP në rajonin e BERZH-it, ku tregjet e kapitalit sipërmarrës janë ende në fazat fillestare, pritet që të kontribuojë në efektin e demonstrimit të vazhdueshëm të sipërmarrjes së suksesshme dhe të kapitalit sipërmarrës si një kategori aktivesh.

## Informacion në lidhje me Klientin

Rast pas rasti

## Përmbledhja e Financave të BERZH-it

250,000,000.00 euro

## Kostoja e Përgjithshme e Projektit

250,000,000.00 euro

## Plotësueshmëria

Kuadri pritet të luajë dy role plotësuese: (i) ofrimin e mbështetjes vendase për bashkinvestitorët për investimet globale të kapitalit sipërmarrës; dhe (ii) rritjen e tregut vendas të sindikalizimit të kapitalit sipërmarrës.

## Përmbledhje Mjedisore dhe Sociale

Ky Kuadër në vetvete nuk kategorizohet sipas Politikës Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it (2019), megjithatë secili nënprojekt do të kategorizohet rast pas rasti dhe do t'i nënshtrohet kontrollit individual mjedisor dhe social (KMS), si dhe projekti dhe klienti do t'i nënshtrohen ekzaminimit specifik TEGJ (tranzicioni në ekonominë e gjelbër). Në varësi të kategorisë së nënprojektit, KMS-ja e përshtatshme do të verifikojë nëse secili nënprojekt është strukturuar në përputhje me Kërkesat e Performancës (KP) të Bankës.

## Informacioni i Kontaktit për Shoqërinë

Bakhrom Ibragimov  
02073386000

## Përmbledhje e zbatimit

## Përditësimi i fundit i PSD-së

14 janar 2022

## Kuptimi i tranzicionit

Informacione të mëtejshme në lidhje me qasjen e BERZH-it për të matur ndikimin në tranzicion mund të gjenden [këtu](#).

## Mundësitë e biznesit

Për mundësi biznesi ose prokurimi, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH-in (që nuk kanë lidhje me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168  
Email: [projectenquiries@ebrd.com](mailto:projectenquiries@ebrd.com)

Për projektet e sektorit shtetëror, vizitoni faqen e [Prokurimeve të BERZH-it](#):

Tel: +44 20 7338 6794  
Email: [procurement@ebrd.com](mailto:procurement@ebrd.com)

## Kërkesa të përgjithshme

Pyetje të veçanta mund të dërgohen me anë të [Formularit të Pyetjeve të BERZH-it](#).

## Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS-ja](#) dhe Kërkesat e Performancës (KP) të lidhura me të përcaktojnë mënyrat se si BERZH-i zbaton angazhimin e vet për të promovuar “zhvillimin e fuqishëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS-ja dhe KP-të përfshijnë dispozita specifike që klientët të jenë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informimin dhe konsultimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmin e ankesave për të marrë dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht për sa i përket performancës mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në përpjesëtim me natyrën dhe shkallën e rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale të projektit, BERZH-i iu kërkon klientëve të tij që të bëjnë publik informacion, kur është e përshtatshme, mbi rreziqet dhe ndikimet që lindin nga

projektet, ose që të kryejnë konsultime domethënëse me palët e interesit, dhe të marrin në konsideratë e t'iu përgjigjen komenteve të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikën e BERZH-it në këtë aspekt paraqitet në [PMS](#).

## Integriteti dhe Pajtueshmëria

Zyra e Kryeoficerit të Pajtueshmërisë (OCCO) të BERZH-it promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare. Të gjithë klientët e Bankës i nënshtrohen kontrollit të integritetit për të siguruar që projektet të mos paraqesin risk të papranueshëm për integritetin ose reputacionin e Bankës. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave në fazat e miratimit të vlerësimit të projektit është mjeti më i efektshëm për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse, si dhe ndihmon në monitorimin e rrezeve ndaj integritetit në fazën pas investimit në projekt.

Gjithashtu, OCCO është përgjegjëse për hetimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shpërdorim detyre në projektet e financuara nga BERZH-i. Kushdo, qoftë pjesë e Bankës ose jo, që ka dyshime për mashtrim ose korrupsion duhet të dërgojë një raport me shkrim drejtuar Kryeoficerit të Pajtueshmërisë me postë elektronike në adresën [compliance@ebrd.com](mailto:compliance@ebrd.com). Të gjitha çështjet e raportuara do të trajtohen dhe ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, duke përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çdo gjuhë të Bankës ose të vendeve ku Banka operon. Informacioni i paraqitur duhet të jepet në mirëbesim.

## Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI-ja përcakton mënyrën se si BERZH-i e bën publik informacionin dhe konsultohet me palët e veta të interesit, në mënyrë që të nxisë ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta, pas hyrjes në fuqi më datë 1 janar 2020. Ju lutemi, vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e internetit të BERZH-it.

Kërkesa të veçanta për informacion mund të dërgohen me anë të [Formularit të Pyetjeve të BERZH-it](#).

## Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies së Projektit (IPAM)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, ose të bërjes publike të informacionit me Klientin ose Bankën nuk janë të suksesshme (p.sh. nëpërmjet mekanizmit të ankesave në nivel projekti të Klientit, ose nëpërmjet angazhimit të drejtuesve të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre nëpërmjet Mekanizmit të Pavarur të Llogaridhënies të Projektit (IPAM) të BERZH-it.

IPAM shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë shkaktuar (ose mund të shkaktojnë) dëm. Qëllimi i Mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të bërjes publike të informacionit; përcaktojë nëse Banka është në

përputhje me [Politikën e saj Mjedisore dhe Sociale](#) ose me dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së saj të Qasjes në Informacion](#); si dhe, kur gjen zbatim, të trajtojë çdo papajtueshmëri ekzistuese me këto politika, duke parandaluar çdo papajtueshmëri nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutemi, vizitoni [fagen e internetit të Mekanizmit të Pavarur të Llogaridhënies së Projektit](#) për të mësuar më shumë rreth IPAM dhe mandatit të tij; se si të [dorëzoni një Kërkesë](#) për shqyrtim; ose kontaktoni IPAM nëpërmjet postës elektronike në adresën [ipam@ebrd.com](mailto:ipam@ebrd.com) për të marrë udhëzime dhe më shumë informacion rreth IPAM dhe se si të dorëzoni një kërkesë.

## Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

## Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: [projectenquiries@ebrd.com](mailto:projectenquiries@ebrd.com)

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: [procurement@ebrd.com](mailto:procurement@ebrd.com)

## Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

## Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit.

Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikën e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

## Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek [compliance@ebrd.com](mailto:compliance@ebrd.com). Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

## Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke [përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

# Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH .

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit [ipam@ebrd.com](mailto:ipam@ebrd.com) për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.